



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
*Qeveria - Vlada - Government*

Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## **Seria 3: Statistikat Ekonomike**

### **Bruto Produkti Vendor - Në Baza Tremujore TM2 – 2014**







Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
*Qeveria - Vlada - Government*

Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## **Seria 3: Statistikat Ekonomike**

### **Bruto Produkti Vendor - Në Baza Tremujore TM2 – 2014**



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS  
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA  
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Botuesi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Data e botimit: Shkurt, 2015

© : *Agjencia e Statistikave të Kosovës*

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

E shtypur nga: K.G.T, Prishtinë, Kosovë

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,  
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ASK-së  
në internet: <http://ask.rks-gov.net>

## **BRUTO PRODUKTI VENDOR - NE BAZA TREMUJORE**

Agjencia e Statistikave te Kosovë (ASK) publikon Bruto Produktin Vendor për TM2 2014 sipas aktiviteteve ekonomike dhe me qasjen e shpenzimeve bazuar në metodologjinë e ESA2010. Vlerësimet e tanishme janë të përkohshme dhe do të rishikohen në bazë të burimeve të reja të të dhënave statistikore dhe administrative dhe përmirësimeve të BPV-së vjetore, në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria me kërkesat e ESA 2010.

BPV ne tremujorin e dytë te vitit 2014 shënon rënie reale për 2.5%. ne krahasim me TM2 të vitit paraprak.


Kjo rënie nëpër aktivitete ekonomike është si vijon: Furnizimi me energji elektrike, me gaz, furnizimi me ujë (17.1%), Industria nxjerrëse me (13.5%); Ndërtimtaria me (11.8%), transporti dhe magazinimi me (10.1%). Rritje kishte ne aktivitetet financiare dhe te sigurimit me 5.5%, Afarizmi me pasuri të patundshme me 4.1% etj.

**Tabela 1:** Bruto Produkti Vendor ne baza tremujore

Tremujoret	2013				2014	
	I	II	III	IV	I	II
BPV me çmime aktuale	1,069.3	1,395.7	1,466.3	1,395.4	1,165.8	1,387.1
BPV me çmimet e vitit paraprak	1,064.9	1,382.4	1,431.0	1,354.6	1,087.3	1,361.0
<b>Rritja reale në % ,1</b>	<b>9.8</b>	<b>6.5</b>	<b>2.1</b>	<b>(2.9)</b>	<b>1.7</b>	<b>(2.5)</b>

1, Me periudhen e njejtë të vitit paraprak

**Grafiku 1.** Rritja reale e BPV-së tremujore



## ***Shënime metodologjike***

### ***1. Mbulueshmëria***

Përlogaritjet përfshijnë të gjitha aktivitetet në bazë të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010).

### ***2. Burimet e të dhënave të përdorura***

#### ***2.1 Burimet e të dhënave statistikore***

Treguesit afatshkurtër ne ASK:

- Indeksi çmimeve të prodhimit (IÇP) në baza tremujore për miniera, prodhim dhe energji elektrike, gaz dhe furnizim me ujë;
- Indeksi i çmimeve të konsumit (IÇK), i vlerësuar në nivelin 4 shifror të COICOP;
- Indeksi i çmimeve të inputeve bujqësore;
- Indeksi i çmimeve të prodhimit bujqësor;
- Te dhënat nga anketa e fuqisë punëtore;
- Statistikat e hotelerisë (numri i vizitorëve dhe numri i netëve).

#### ***2.2 Burimet e të dhënave administrative***

Burimet e të dhënave administrative mujore dhe tremujore të përdorura për vlerësimin e BPV-së tremujore janë:

- Të dhënat mujore të njësive jo-financiare të marra nga Administrata Tatimore e Kosovës (të dhënat mujore lidhur me qarkullimin, pagat, kontributet për sigurime shoqërore, numri i të punësuarve, blerjet dhe shpenzimet);
- Të hyrat dhe shpenzimet e qeverisë në baza mujore;
- Pasqyrat financiare të Bankës Qendrore, bankave komerciale dhe kompanive të sigurimit;
- Të dhënat në baza mujore për bilancin e pagesave të elaboruar në Bankën Qendrore;

### **3. Metoda e vlerësimit**

Llogaritë kombëtare në baza tremujore përdorin të njëjtat parime, përkufizime, dhe strukturë sikurse edhe llogaritë vjetore.

### **4. Paraqitja e të dhënave**

Të dhënat kryesore dhe kategoritë e paraqitura janë sipas koncepteve dhe terminologjisë së harmonizuar të ESA 2010. Të dhënat sipas aktiviteteve janë paraqitur sipas Klasifikimit statistikor të Aktiviteteve Ekonomike të Bashkësisë Evropiane (NACE Rev.2).

Te dhënat ne baza tremujore janë paraqitur ne tabelat ne vijim me çmime aktuale dhe si matje e vëllimit me çmime te vitit paraprak.

### **5. Përkufizime dhe shpjegime**

**Bruto Produkti Vendor** me qasjen e prodhimit është i barabartë me vlerën e shtuar sipas aktiviteteve me çmime bazë, e rritur me tatimet mbi produkte, dhe të zvogëluar për vlerën e subvencioneve në produkte. Në këtë mënyrë Bruto Produkti Vendor është i barabartë me shumën e vlerës së shtuar me çmime bazë të të gjitha njësive të prodhimit të një vendi (rezidentë) dhe tatimeve neto në produkte (tatimet minus subvencionet mbi produkte).

**Vlera e shtuar** me çmime bazë është e barabartë me outputin me çmimet bazë, të zvogëluar për konsumin e ndërmjetëm me çmime blerëse.



**Bruto Produkti Vendor - Në Baza Tremujore TM2 – 2014**

Tabela 2. Bruto produkti vendor në baza tremujore sipas aktiviteteve ekonomike me çmime aktuale

(në milion Euro)

Nace Rev.2	Bujqësia, gjuetia , pylltaria dhe peshkimi	Industria nxjerrëse	Industria përpunuese	Furnizimi me energji elektrike, me gaz- Furnizimi me uje	Ndërtimtaria	Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	Transporti dhe magazinimi	Hotelet dhe restorantet	Aktivitetet financiare dhe te sigurimit	Afarizmi me pasuri të patundshme	Administrimi publike	Sherbime të tjera	BVSH me çmime bazë	Tatimet minus subvencione t në produkte	Bruto Produkti Vendor	
	A	B	C	D+E	F	G	H	I	K	L	O	J+M+N+P+Q+R+S+T				
2013	638.7	118.3	584.8	196.9	352.2	655.4	233.7	49.8	213.3	475.5	748.0	169.0	4,436	891.1	<b>5,326.7</b>	
2013	TM 1	136.0	30.9	100.5	50.2	62.9	126.0	49.1	11.2	49.8	121.2	149.9	25.1	912.7	156.5	<b>1,069.3</b>
	TM 2	182.5	29.1	144.5	55.8	105.3	159.8	58.1	12.3	53.8	117.7	187.3	68.0	1,174.2	221.5	<b>1,395.7</b>
	TM 3	165.8	25.9	174.5	48.9	107.3	191.4	77.3	14.4	53.5	117.8	185.1	31.4	1,193.4	272.9	<b>1,466.3</b>
	TM 4	154.4	32.4	165.3	42.1	76.6	178.2	49.2	11.9	56.1	118.9	225.7	44.5	1,155.3	240.1	<b>1,395.4</b>
2014	TM 1*	134.2	36.9	95.8	51.5	64.8	124.2	44.7	14.9	53.7	131.8	186.1	45.1	983.6	182.1	<b>1,165.8</b>
	TM 2*	179.7	33.3	139.5	48.4	92.7	142.9	51.0	12.5	60.5	130.9	210.0	61.6	1,163.0	224.1	<b>1,387.1</b>

\* E vlerësuar

**Bruto Produkti Vendor - Në Baza Tremujore TM2 – 2014**

Tabela 3 Bruto produkti vendor në baza tremujore sipas aktiviteteve ekonomike me çmimet e vitit paraprak

(në million Euro)

Nace Rev.2	Bujqësia, gjuetia, pylltaria dhe peshkimi	Industria nxjerrëse	Industria përpunuese	Furnizimi me energji elektrike, me gaz- Furnizimi me uje	Ndërtimtaria	Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	Transporti dhe magazinimi	Hotelet dhe restorantet	Aktivitetet et financiare dhe te sigurimit	Afarizmi me pasuri të patundshme	Administrimi publike	Sherbime te tjera	BVSH me çmime bazë	Tatimet minus subvencio net në produkte	Bruto Produkti Vendor	Në % ne krahasim me periudhen e vitit paraprak	
	A	B	C	D+E	F	G	H	I	K	L	O	J+M+N+P+Q+R+S+T					
2013	626.3	131.5	585.0	189.4	350.1	638.7	217.7	38.1	202.1	455.3	742.7	182.5	4,359.3	873.5	<b>5,232.9</b>	103.4	
2013	TM 1	124.4	33.8	109.7	46.9	61.6	117.7	43.9	8.6	45.6	126.2	145.5	37.2	901.0	163.9	<b>1,064.9</b>	109.8
	TM 2	173.0	30.2	145.9	54.9	105.0	152.4	54.9	9.4	51.3	119.5	185.3	41.8	1,123.6	258.8	<b>1,382.4</b>	106.5
	TM 3	170.6	30.2	170.1	48.7	107.6	184.0	73.6	11.3	51.1	97.4	185.9	43.8	1,174.3	256.7	<b>1,431.0</b>	102.1
	TM 4	158.4	37.3	159.3	38.9	75.8	184.5	45.4	8.7	54.1	112.1	226.0	59.8	1,160.4	194.2	<b>1,354.6</b>	97.4
2014	TM 1*	134.8	37.3	100.8	51.8	58.8	123.1	41.3	14.6	53.2	121.7	154.4	37.1	928.8	158.5	<b>1,087.3</b>	101.7
	TM 2*	180.5	25.2	140.8	46.2	92.9	156.7	52.2	12.3	56.8	122.6	189.4	61.9	1,137.5	223.5	<b>1,361.0</b>	97.5
<i>Norma reale sipas aktiviteteve TM2 2014/TM2 2013</i>	(1.1)	(13.5)	(2.5)	(17.1)	(11.8)	(1.9)	(10.1)	0	5.5	4.1	1.1	(9.0)			(2.5)		

\* E vlerësuar

Bruto Produkti Vendor - Në Baza Tremujore TM2 – 2014

Tabela 4. Bruto Produkti Vendor në baza tremujore me qasjen e shpenzimeve me çmime aktuale

BPV me çmime aktuale		(në milion Euro)							
		Shpenzimet e konsumit final	Shpenzimet e konsumit final te ekonomive shtëpiake	Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	Formimi I bruto kapitalit	Eksporti neto	Eksporti I mallrave dhe shërbimeve	Importi I mallrave dhe shërbimeve	
		1 = 2+5+6	2 = 3+4	3	4	5	6 = 7-8	7	8
2013		<b>5,326.6</b>	5,539.3	4,675.4	863.9	1,470.7	(1,683.4)	924.0	2,607.4
2013	TM1	<b>1,069.2</b>	1,095.7	923.8	171.9	303.7	(330.2)	176.1	506.3
	TM2	<b>1,395.7</b>	1,435.7	1,228.7	207.0	398.9	(438.9)	230.3	669.2
	TM3	<b>1,466.3</b>	1,502.5	1,297.8	204.7	391.6	(427.8)	312.4	740.2
	TM4	<b>1,395.4</b>	1,505.4	1,225.0	280.4	376.5	(486.5)	205.2	691.7
2014	TM1	<b>1,165.8</b>	1,218.0	1,011.1	206.9	277.7	(329.9)	190.1	520.0
	TM2	<b>1,387.1</b>	1,447.3	1,203.5	243.8	403.8	(464.0)	239.0	703.0

\*E vlerësuar

Bruto Produkti Vendor - Në Baza Tremujore TM2 – 2014

Tabela 5. Bruto Produkti Vendor në baza tremujore me qasjen e shpenzimeve me çmime konstante

(në milion Euro)

BPV me çmime konstante		Shpenzimet e konsumit final	Shpenzimet e konsumit final te Ekonomive shtëpiake	Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	Formimi I bruto kapitalit	Eksporti neto	Eksporti I mallrave dhe shërbimeve	Importi I mallrave dhe shërbimeve	Në % në krahasim me periudhen e vitit paraprak	
1 = 2+5+6		2 = 3+4	3	4	5	6 = 7-8	7	8	9	
2013		<b>5,232.8</b>	5,437.8	4,568.2	869.6	1,460.2	(1,665.2)	944.7	2,609.9	103.4
2013	TM1	<b>1,064.9</b>	1,094.7	923.1	171.6	284.6	(314.4)	178.9	493.3	109.8
	TM2	<b>1,382.4</b>	1,431.8	1,223.0	208.8	391.7	(441.2)	234.0	675.2	106.5
	TM3	<b>1,431.0</b>	1,450.7	1,240.3	210.4	404.8	(424.6)	319.8	744.3	102.1
	TM4	<b>1,354.6</b>	1,460.6	1,181.7	278.8	379.1	(485.0)	212.0	697.0	97.4
2014	TM1*	<b>1,087.3</b>	1,146.8	960.7	186.1	300.8	(360.3)	189.1	549.4	101.7
	TM2*	<b>1,361.0</b>	1,390.7	1,169.0	221.7	418.1	(447.8)	237.7	685.5	97.5

\*E vlerësuar



# Agjencia e statistikave të Kosovës

## *përshkrim i shkurtër*

**Agjencia e statistikave të Kosovës** është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

**Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: *Departamentet prodhuese;* (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. *Departamentet mbështetëse;* (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamenti i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. **Ne kuadër të Agjencionit vepron edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj**

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 139 punëtorë, prej tyre, 104 (74,8%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 35 (25,2%), Agjencioni ka ketë strukturë kualifikuese, 70,5% me shkollim universitar ndërsa 29,5% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikatat e shteteve në rajon.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësisve raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Kemi realizuar me sukses në vitin 2011 projektin e Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe banesave, i cili regjistrim nuk është realizuar që nga viti 1981. Rezultatet e fituara nga ky regjistrim do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

**Misioni i Agjencionit;** të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë. Në vijim e sipër është përgatitja për Regjistrimin e Bujqësisë në Kosovë.

- o **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**  
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- o **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129  
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- o **Fax:** +381 (0) 38 235 033
- o **E-mail:** [economic@rks-gov.net](mailto:economic@rks-gov.net)
- o **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>